



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1865/4 prot.

Datë 03/08/2023

V E N D I M
Nr. 717/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03/08/2023, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr. 1865 prot., datë 31.07.2023 për procedurën e prokurimit “Proçedurë e hapur e thjeshtuar – Marrëveshje kuadër”, me Nr. REF-72694-06-15-2023, me objekt: “Blerje materiale elektrike”, me fond limit 7.499.926 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 27.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike.

Ankimues: Operatori ekonomik “2AS INVEST” SHPK
Adresa: Lagjja 13, Plazh, Zona Kadastrale 8518, Nr. Pasurie 58/338+1-43, kati tetë, Durrës.

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Shërbimeve Publike
Adresa: Lagjja "Shkumbini", Elbasan.

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “AlbaScan” SHPK
Adresa: Rruga “Barrikada”, Hyrja 1, Përballë Gjimnazit “Sami Frashëri”, Zona kadastrale 8360, Nr pasurie 5/351 Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I*****Vlerësimi paraprak***

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II***Rrethanat e çështjes***

II.1. Në datën 16.06.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar – Marrëveshje kuadër”, me Nr. REF-72694-06-15-2023, me objekt: “Blerje materiale elektrike”, me fond limit 7.499.926 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 27.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike.

II.2. Në datë 27.06.2023, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3. Në datën 26.07.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “SAM-ARS 2016” SHPK me vlerë oferte 59.800 leke skualifikuar
2. “AlbaScan” SHPK me vlerë oferte 63.611 leke kualifikuar
3. “2AS INVEST” SHPK me vlerë oferte 124.860 leke kualifikuar

II.4. Në datën 27.07.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak, duke shpallur fitues ofertën e shoqërisë “AlbaScan” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datë 31.07.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1865 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3321, e operatorit ekonomik “2AS INVEST” SHPK, pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik “AlbaScan” SHPK, pasi nuk ka plotësuar kriteret e veçanta të kualifikimit të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimimi.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1865/2, datë 01.08.2023, lidhur kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “AlbaScan” SHPK, pasi nuk ka plotësuar kriteret e veçanta të kualifikimit, të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimimi.

II.7. Me shkresën e datës 03.08.2023, protokolluar me tonën me nr. 1865/3 prot, datë 03.08.2023, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave operatori ekonomik ankimues “2AS INVEST” SHPK është tërhequr nga ankesa me me numër ankimi elektronik A/2023/3321, duke u shprehur sin ë vijim: “Terheqje nga ankesa me numer A/2023/3321

Kompania jone shqyrtoi dhe njehere arsyet e skualifikimit nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe dolem ne perfundimin se AK na ka s'kualifikuar ne menyre te drejte per arsye se ne nuk plotesojme nje sere dokumentacionesh dhe nuk mund te shpallemi dot fitues. Me kete dokument njoftojme terheqjen nga ankesa e bere nga ana jone.

Faleminderit per bashkepunimin! “.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “2AS INVEST” SHPK për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar – Marrëveshje kuadër*”, me Nr. REF-72694-06-15-2023, me objekt: “*Blerje materiale elektrike*”, me fond limit 7.499.926 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 27.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me nr. 1865 protokoli, datë 31.07.2023 dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3321, për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar – Marrëveshje kuadër*”, me Nr. REF-72694-06-15-2023, me objekt: “*Blerje materiale elektrike*”, me fond limit 7.499.926 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 27.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “2AS INVEST” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

